



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

KEC

Projekti: Qendra Didaktike

STUDIM RASTI



Prishtinë,
mars 2002

Përpiluar nga:
Xhafer Ahmeti
Janne Riecki
Säde Urpola

I HYRJE

Qendra për Arsim e Kosovës (Kosova Education Center) është organizatë joqeveritare e themeluar nga Fondacioni “SOROS”.

KEC ushtron veprimtari në fushën e edukimit dhe është e specializuar për trajnimin e punëtorëve të arsimit për zbatim të suksesshëm të strategjive bashkëhore të mësimdhënjes. Në kuadër të saj implementohen një numër i konsiderueshëm i projekteve, ndër to edhe projekti: Qendrat Didaktike.

Projekti “Qendra Didaktike”, financohet nga donatorët:

- Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS)
- KulturKontakt-Austri
- Ministria e Arsimit-Austri
- Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (DEZA)

Deri më tani me ndihmën e këtyre donatorëve, janë hapur Qendrat Didaktike në këto qytete të Kosovës (shiqo SHTOJCËN I):

- Prizren (sh.f. “Abdyl Frashëri”)
- Ferizaj (sh.f. “Gjon Serreçi”)
- Pejë (sh.f. “Vaso Pashë Shkodrani”)

Në muajin prill do të hapet Qendra Didaktike në Gjakovë kurse në muajt e ardhshëm edhe në Gjilan (shiqo SHTOJCËN II). Të gjitha këto qendra kanë karakter regjional.



Qendra Didaktike në Prizren

II QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PROJEKTIT

Arsimtarët kosovarë janë shumë të përkushtuar ndaj profesionit të tyre dhe gjithmonë kanë treguar përcptueshmëri ndaj risive madje edhe në kohën kur kanë qenë të privuar nga çdo gjë ka pasë lidhje me statusin e tyre të zakonshëm. Mungesa e çfarëdo sistemi të qëndrueshëm të aftësisë (in-servis) për arsimtarët që janë duke punuar e ka dëmtuar rëndë kualitetin e mësimdhënjes në shkollat kosovare, e cila karakterizohet me përdorimin e metodologjive dhe strategjive tradicionale të mësimdhënjes. Në anën tjetër, mungesa e mjeteve për mësimdhënje kualitative është një problem tjetër me të cilin duhet të mirremi menjëherë.

Hapja e Qendrave Didaktike nëpër qendrat regjionale të Kosovës iu ofron mësimdhënësve mundësi që të përdorin materiale për mësimdhënje dhe pajisje tjera moderne, me qëllim të avansimit të aftësive të tyre të mësimdhënjes dhe kështu të ndikojnë në përparimin e procesit të mësimdhënjes.

A) QËLLIMI

Projekti “Qendra Didaktike” ka këto qëllime:

- 1. Përparimi (avansimi) në procesin e mësimdhënjes.** Ky është një synim shumë i gjerë dhe nuk do të arrihet plotësisht vetëm me hapjen e Qendrave Didaktike. Në vend të kësaj, projekti do të kontribuojë në procesin më të gjerë të përparimit të procesit të mësimdhënjes. Hapja e Qendrave Didaktike, do të krijojë kushte që mësimdhënësit të zhvillojnë dhe përmisojnë aftësitë e tyre të mësimdhënjes dhe në këtë mënyrë të shkaktojnë përparim në procesin e mësimdhënjes.
- 2. Krijimi i sistemit informativ për strategjitë, metodologjitë dhe risitë bashkëkohore.**
- 3. Pjesëmarrja në zhvillimin e sistemit të trajnimit të personelit mësimor-edukativ në shërbim (in-servis).**

B) OBJEKTIVAT


Objektivat për këtë projekt janë si vijon: Krijimi i kushteve teknike për përgaditjen e aktiviteteve mësimore, mundësimi i qasjes së informatave, krijimi i mundësive për zhvillimin e procesit të qarkullimit të përhershëm të informacionit dhe organizimi i aftësimeve (trajnimeve) në shërbim (in-servis) për administrator të shkollave dhe personelin mësimor-edukativ parauniversitar.

Struktura dhe funksioni i Qendrës Didaktike

Çdo qendër didaktike përbëhet nga dy dhoma:

- a) Dhoma e trajnimit, dhe
- b) Punëtorja ose dhoma “make and take”

Qendra didaktike është e pajisur me kompjutor, apart fotokopijues, posterë, sllajde (diapozitiv), grafoskop si dhe mjete tjera teknike, të cilat gjithëmon janë në shërbim të mësimdhënësve.



Disa nga aktivitetet ne qendër

I OPINIONET E MËSIMDHËNËSVE DHE STAFIT TË QENDRAVE

A) Opinionet e mësimitdhënësve

Shpresa Abdullahu,
arsimtare e gjuhës angleze,
sh.f. Shkolla e Re,
Ferizaj



“Qendra Didaktike është një ndihmë shumë e madhe për punëtorët e arsimit sepse na ka ofruar mjete dhe materiale të shumta përmes të cilave procesi mësimor zhvillohet më lehtë. Kjo qendër organizon kurse, seminare të ndryshme, gjithëashtu këtu mund të përdoren edhe kompjuteret si dhe interneti, cka do të thotë shumë për ne që më parë nuk i kemi pas rast ti kemi.”

Remzije Gagica,
arsimtare e gjuhës angleze,
sh.f. Shkolla e Re,
Ferizaj



“Për këtë qendër mendojë se është jashtëzakonisht e nevojshme për mësimitdhënësit, meqense më herët nuk kemi pas rast të kemi këso qendra. Na ofron shumë mundësi kjo është përparësia e kësaj qendre, që në kohën e sotme janë jashtëzakonisht të nevojshme. Në qendër kemi rast të bashkëpunojmë me të tjerët gjatë vijimit të kurseve të ndryshme si: kursit me kompjuter, internet si dhe gjatë seminareve të ndryshme të organizuar nga qendra didaktike si dhe nga të tjerët...”


Sabri Berisha,
drejtor,
sh.f. “Gjon Serreçi”,
Ferizaj



“Qendra didaktike është ndihmesë e madhe për ushtrimin dhe trajnimin e mësimeve me metoda më bashkëkohore, prandaj mendojë se në çdo qytet të Kosovës lypset të ketë këso qendra.

Ndihmesa e procesit mësimor është e madhe me ushtrimet dhe trajnimet që bëhen në qendrën didaktike.”

Suzana Ajdini-Hamza,
arsimtare e matematikës,
sh.f. “Gjon Serreçi”,
Ferizaj



“Qendra didaktike është ndihmesë e madhe për mësuesit, sepse na ofron mjete dhe materiale për zhvillimin e procesit mësimor. Na është mundësuar ndjekja e kursit të kompjuterëve si dhe të gjuhës angleze. Me materialet e qendrës krijojmë modele, ilustrime që na lehtësojnë mirëmbajtjen e orës mësimore. Në qendër mbahen edhe seminare për trajnimin e arsimtarëve për aplikimin e metodave të reja mësimore. Këtu takohen arsimtarët nga shkollat e ndryshme dhe bëjmë këmbimin e mendimeve dhe bashkëpunimeve për ngritjen e nivelit në mësim.”

Ilmi Hashani,
profesor i fizikës,
gjimnazi “Kuvendi i Arbërit”
Ferizaj



“Qendra diaktike mendojë se është një ndihmesë e madhe e cila mundëson përgaditjen e arsimtarëve për forma të reja mësimore.”


Qerim Rexhepi,
profesor i letërsisë dhe gjuhës
shqipe
gjimnazi “Kuvendi i Arbërit”
Ferizaj



“Qendra didaktike në Ferizaj është vend ku takohen mësime të reja për të shkëmbyer mendime, ide të reja. Aty marrim informacione të nevojshme dhe është një lehtësim i madh për të gjithë që janë të përkushtuar ndaj punës së tyre fisnike dhe të vleshme që të edukojnë gjeneratat e reja.

Shërbimet që i ofron kjo qendër janë të mirëseardhura për të gjithë arsimdashësit. E përgëzojë për suksesin që ka bërë kjo qendër.”

Besa Hoxha-Beqiraj,
arsimtare e gjuhës angleze,
sh.f. “Gjon Serreçi”,
Ferizaj



“Unë mendojë që kjo qendër është shumë e mirëpritur për të gjithë arsimtarët e të gjitha shkollave.”


Në rend të parë do të kisha theksuar për personelin e qendrës që janë shumë të afërt me të gjithë arsimtarët d.m.th, kanë sjellje korekte.

Këty mbajmë kurse të kompjuterëve, të gjuhës angleze, pastaj kurdo që të kemi nevojë për të fotokopijuare teste për nxënës, këtë punë e kryejmë këtu.

Me një fjalë unë konkretisht ndihem shumë e lumtur sa i përket këtyre mundësive të nevojshme që na ka ofruar kjo qendër.

Njëherët falenderojë gjithëzsatifin e KEC-it për ndihmën që kanë ofruar për qendrën didaktike.”

Malikije Maliqi,
arsimtare e historisë,
sh.f.”Gjon Serreçi”,
Ferizaj




“Hapja e qendrës didaktike është një ndihmes e madhe për të gjithë mësimdhënësit e komunës sonë por edhe të atyre përreth. Në këtë qendër po behen trajnime të shumta si për metodat e reja të mësimdhënjes poashtu edhe kurse të tjera si të gjuhës angleze, kompjuterëve etj.

Mbajtja e këtyre trajnimeve është një sukses i madh dhe po çon në ngritjen e metodologjisë mësimore. Në qendër mësimdhënësit kanë mundësi të përdorin internetin dhe gjithëashtu mjete të konkretizimit, ku ato mund të huazohen ose edhe vet të krijohen.

Në fund theksojë se hapja e qendrave të tilla është e nevojshme dhe e domosdoshëme edhe në komunat tjera.”

Lindita Isufi,
drejtoresh e shkollës së muzikës
“Çesk Zadeja”,
Ferizaj



“Hapja e qendrës didaktike i dha ndihmë të madhe punëtorëve që janë të kyqur në procesin edukativo arsimor.

Arsimtarët në këtë qendër mund të përfitojnë shumë njohuri nëpërmes kurseve dhe seminareve që po organizohen në këtë qendër.

Këtu mësimitdhënësit po kanë mundësi të mësojnë metodat dhe të përdorin mjete më bashkëkohore gjë që po u ndihmon shumë në zhvillimin normal të procesit mësimor.”

Halit Buzhala,
këshilltar (inspektor) i
matematikës
Prizren



“Me hapjen e Qendrës Didaktike në Prizren u krijua një burim kryesor për ndihmë arsimtarëve gjatë punës së tyre. Që në fillim, bashkëpunimi në mes Institutit Pedagogjik dhe Qendrës Didaktike ka qenë në nivel të duhur.

Në këtë qendër janë bërë trajnime të ndryshme të arsimtarëve ku atyre iu afruan kushte solide për mirëvajtjen e trajnimeve.

Arsimtarët e Prizrenit dhe të rrethinës krijojnë materiale didaktike për mësimitdhënje dhe mësimitnxënje e të cilët shpesh kërkojnë udhëzime nga punëtorët e Institutit Pedagogjik dhe nga stafi i qendrës.

Punëtorët e Institutit Pedagogjik, në qendrën didaktike kanë kryer trajnime të ndryshme në mëminë e arsimit së bashku me stafin e qendrës dhe janë duke përgaditur së bashku një prijekt për zbatimin e teknikave të reja të mësimitdhënjes në lëndët e shkencave natyrore, që më vonë parashihet të bëhet edhe trajnimi i arsimtarëve nga këto lami.

Këshilltarët pedagogjik dhe shumë punëtorë tjerë të arsimit, kanë kryer kursin për kompjuter në këtë qendër dhe janë aftësuar të përgadisnin materialet e nevojshme për mësimitdhënje.”

Sadije Jakupi,
arsimtare në sh.f.
“Abdyl Frashëri”,
Prizren


“Si arsimtare e shkollës “A. Frashëri “ pata fat që qendra didaktike të jetë gjithëmonë në dispozicion timin. Së bashku me stafin punues kemi punuar në hartimin e testeve për vlerësimi e njohurive dhe qëndrushmërin e tyre, nga lënda e matematikës. Këto teste i kam fotokopijuar dhe shpërndar nxënësve, të cilat i kan pritur shumë mirë dhe kërkonin që vazhdimisht të bëjnë teste të tilla. Kjo ka ndikuar edhe në vlerësimin objektiv të vlerësimin të njohurive të nxënësve.

Jam aftësuar edhe në kompjuter fjalë organizimit të kursit për kompjuter të organizuar nga stafi punues i Qendrës Didaktike dhe tash jam në gjende që vetë t'i shkruaj testet, planet mujore të punës, planifikimin e orëve mësimore dho materialit tjetër të nevojshëm shkollor si dhe hartimin e materialit për përgatitjen e orëve mësimore me teknika të reja të mësimitdhënjes.

Pasi jam e inkuadruar edhe në programin e MKLSH, organizuar nga KEC-i, ku trajnimet i mbajmë në Qendrën Didaktike, në bisedë me pjesëmarrësit tjerë të seminarit, kemi bindjen se në lokalet e Qendrës Didaktike egziston një atmosferë pune jashtëzakonisht e mirë e këtë atmosferë të mirë e rritë edhe më tepër puna dhe sjellja e stafit punes së kësaj Qendre.

Stafin punues e përshendesë për zemërsishtë dhe u uroj punë të mbarë sepse mendoja se janë duke kryer një punë të shenjtë dhe kam një mesazh: vetëm vazhdoni të punoni sikuresë deri tash.”


Fëllanza Ballëku,
mësuese në sh.f.
“Motrat Qiriazit”,
Prizren



“Kur dëgjova në radio për hapjen e qendrës didaktike dhe nga kureshtja vendosa tyë vizitojë këtë qendër. Nuk kisha ide se si do të më ndihmojë një qendër e tillë. Pasi që ubëra anëtare e kësaj qendre dhe me këshillat dhe sygjerimet e stafit të qendrës fillova të shfrytëzojë kushtet që i ofron kjo qendër për një mësimdhënës. Që nga dita e antarësimit, unë bilke së paku tri herë në javë vizitojë qendrën ku bëjë prëgaditjen e shkronjave, numrave dhe ilustrimeve për nxënës,

Kjo mënyrë e prëgaditjes së mësimit po jepë rezultate, ku vërehet tek interesimi i nxënësve të cilët me padurim e presin shkronjën e re ngase kushte që i ofron qendra didaktike mësimi i shkronjave është shumë më atraktiv dhe interesant. Mënyra se si po i prëgadisë shkronjat i bëri kureshtar edhe kolegët e mija, të cilat edhe u bënë anëtare të qendrës. Për fund mund të them se hapja e qendrave të tilla ndikon shumë në ngritjen e cilësisë së mësimit në shkolla tona.”

Gëzime Bardhi,
sekretare e sh.f.
“Emin Duraku”,
Prizren



“Mendojë se themelimi i qendrave didaktike është një projekt i qëlluar, pikërisht për nevojat e arsimtarëve. Me rasti e mbajtjes së një seminari për themelimin e OJQ, në muajin nëntor të vitit 2001, ne pjesëmarrësit e këtijë seminari e shijua vlerën e qendrës didaktike, ku patëm

mundësi që trajnimi të realizohen në tërësi, duke filluar nga puna me grupe e deri te mënyrat tjera.”


Nexhed Kuqani,
drejtor i sh.f.
“ Emin Duraku “
Prizren



“Kjo qendër është objekt kapital për regionin e Prizrenit, sidomos për mësimdhënësit e shkollave. Edhe pse kjo qendër u fillojë me punë vetëm para tetë muajve për shkollën tonë paraqet një ndihmës të madhe sa i përket aftësimin dhe përgatitjes së mësimdhënësve. Punëtorët e shkollës këtë qendër e shfrytëzojnë për tu trajnuar në përdorimin e kompjuterëve, pastaj përgatitjen e mjeteve didaktike, shtypjen dhe shumëzimin e testeve etj. Si shkollë kemi shfrytëzuar lokalet e qendrës edhe për mbajtjen e një trajnimi ndërkombëtar, ku ky trajnim është vlerësuar me notë të lartë duke iu falenderuar në radhë të parë kushteve shumë të mira që ofron qendra por edhe shërbimeve efikase dhe cilësore nga stafi i qendrës. Besojë që edhe në të ardhmen kjo qendër do të na dalë në ndihmës si mësimdhënësve të shkollës sime por edhe të gjithë të tjerëve.”

B) Opinione të stafit të qendrave

Sheqer Shllaku,
koordinatori i qendrës
didaktike,
Ferizaj



“Qendra didaktike në Ferizaj është hapur më 21.09.2001. Deri në fund të janarit 2002 në gjirin e vet përfshin 306 antarë. Mesatarja e antarëve që punojnë në qendër gjatë ditës është 60-80 veta. Arsimitarët punojnë në dhimën mbaro dhe ikë, me ndihmesën e stafit të qendrës por edhe në mënyrë individuale.

Mësimdhënësit avansohen edhe përmes trajnimeve, seminareve dhe debateve me tema të ndryshme mësimorë.

Propagandimi dhe informimi i qendrës bëhet përmes mediave si radio stacione dhe dy televizioneve lokale. Kështu vetëm Tv-Liria gjerë më tani ka bërë katër pesë vizita në qendër,

katër reportazhe të shkurta, ku janë intervistuar mësues, arsimtar, drejtorë dhe punëtor tjerë në arsim.

Mendimet e mësimeve lidhur me punën e qendrës janë superlative. Unë mendoj se qendra shfrytëzohet shumë mirë, mirëpo kam një vrejje lidhur me huazimin e mjeteve nga qendra. Kështu grafoskopët, diaproskopët si dhe mjete tjera shumë rrallë huazohen, kjo edhe kuptohet deri diku pasi që në qendër ende mungojnë transparenca dhe diapozitivët për lëndët e ndryshme.

Gjatë kësaj kohe sa është e hapur qendra, këtu janë mbajtur seminare dhe takime të shumta. Për fund të theksoj se është e pamundur të cekem edhe shumë aktivitete të tjera.


Personalisht për të ardhmen e qendrës jam optimist, nëse financohet.”

Sehadete Konjufca,
ndimëskordinatore në
qendrën didaktike,
Ferizaj



“Personalisht jam shumë optimiste për zhvillimin e qendrës didaktike në të ardhmen. Momentalisht interesimi i arsimtarëve është shumë i madh me atë çka ofrojmë ne. Përkundër vështërsive tjera që kanë mësimeve ata prapë prap vijën në këtu të konsultohen për orët mësimore, huazojnë mjete teknike që posedon qendra, propozojnë metoda të ndryshme të zhvillimit të mësimt si dhe ndjekin seminare të ndryshme dhe trajnime që i ofron qendra.”

Shqipe Abazi,
ndihmëskordinatore e
qendrës didaktike,
Ferizaj



“Në kushtet dhe rrethanat nëpër të cilat po kalon i tërë sistemi edukativo-arsimor, hapja e qendrës didaktike i gjason një oaze në shkretirë. Funksionaliteti i saj është shumë i rëndësishëm sidomos në aspektin e ngritjes së cilësisë së mësimeve si dhe të riaftësimin e mësimeve për një sistem më të avansuar mësimor.

Me trajnimet, seminarët, kurset e ndryshme që organizohen këtu në qendër iu mundësohet mësimdhënësve të lëvizin nga pozita e ngërrir që kanë mbetur një kohë të gjatë në këtë sferë të rëndësishme për shoqërinë tonë.

Qendra didaktike do të ketë një vazhdimësi të punës nëse të gjithë subjektet që kanë fokus në arsim angazhohen dhe bashkëpunojnë gjithënjë në të mirë të sistemit edukativo-arsimor.”

Bedri Rexhepi,
kordinator i qendrës
didaktike,
Prizren




“Me 25.05.2001 u hap qendra didaktike në Prizren, në lokalet e shkollës fillore “Abdyl Frashëri”. Kjo qendër ka për qëllim t’i ndihmojë arsimtarët e regjionit të Prizrenit duke përfshirë këtu komunat e Rahovecit, Therandës, Sharrit dhe Malishevës.

Gjatë periudhës maj 2001-janar 2002 , në qendër janë anëtarësuar mbi 320 arsimtar të shkollave fillore dhe të mesme. Arsimtarët filluan të hartojnë lloje të ndryshme të testeve për këlasë të ndryshme dhe pastaj edhe i shumëzuan në qendër. Këto teste u punuan edhe në gjuhët e komuniteteve si në atë turke dhe boshnjake, pasi që anëtar të qendrës janë edhe arsimtarët nga këto komunitete. Në qendër u ndërtuan modele shkronjash për nx. E klasës së parë të cilat iu dhanë mësuesëve , dhe ilustrime të ndryshme. Në qendër edhe u fotokopijuan mbi 110.000 kopje të ndryshme si, teste, planifikime të orëve, plane javore, plane mujore të arsimtarëve etj.

Po ashtu, gjatë kësaj kohe u organizua kursi për kompjuter ku pjesërisht u aftësuan mbi 60 arsimtar në shkollave fillore dhe të mesme. Arsimtarëve u është ndihmuar edhe me huazimin e ilustrimeve, diaprojektorëve, grafoskopëve, kasetofonëve etj., me të cilat disponon qendra. Arsimtarët u ndihmuar edhe në mënyra tjera me këshilla por edhe me trajnime dhe seminare të ndryshme të organizuara nga KEC-i por edhe nga organizmat tjerë.”

Mejreme Nevzati,
ndihmëskordinator
në qendrë didaktike,
Prizren



“Hapja e qendrës didaktike ka rëndësi shumë të madhe për ngritjen e cilësisë në mësimdhënje. Këtë edhe si duket e kanë kuptuar edhe arsimtarët të cilët vijnë dhe regjistrohen në këtë qendër. Në qendër , përveqë pregaditjeve për orë të mësimi që bëjnë arsimtarët , organizohen edhe takime por dhe debate në mes tyre. Interesimi i arsimtarëve është i madh sidomos për formulimin dhe pregaditjen e testeve të lëndëve të ndryshme.

Momentalisht lidhur me punën me teste, jemi duke pregaditur një trajnim me arsimtarët e matematikës. Në fund ju jemi mirënjohës KEC-it dhe të gjithë atyre që dhanë ndihmes për hapjen e kësaj qendre.”

Shkelzen Kryeziu,
ndihmëskordinator
në qendrë didaktike,
Prizren

“Që nga fillimi i punës në qendër kemi qenë të angazhuar në kontakte të shumta me arsimtarët e regjionit të Prizrenit e ku janë përfëshur edhe arsimtar të komunitetit boshnjak dhe turk. Me konsultimin e arsimtarëve lëndor dhe klasor kemi përpiluar mbi 70 teste të llojllojshme. Konsultimet dhe këshillimet janë të përditëshme si individuale po ashtu edhe grupore duke organizuar takime me arsimtar të aktiveve profesionale.”

Amire Biraj,
ndihmëskordinatore
në qendrë didaktike,
Prizren

“Puna ime në qendër manifestohet më së shumti në dhomën “Puno dhe ik” ku bashkëpunojë me arsimtarët e regjionit të Prizrenit. Këtu janë krijuar dhe përpiluar shumë ilustrime, teste nga lëndë të ndryshme, është bërë formulimii shkronjave, janë mbaruar figura dhe trupa që shërbejnë për realizimin e mësimi sa më të suksesëshëm. Puna e qendrës didaktike si dhe shërbimi i ynë vazhdon të jetë në shërbim të arsimtarëve edhe më tutje, me këshilla dhe ide të reja.”

II PËRFUNDIM

Nëse mendojmë për një periudhë më të gjatë, hapja e Qendrave Didaktike në Kosovë është në fazën fillestare. Qendra Didaktike e parë, është hapur në Maj të vitit 2001, pastaj është hapur në Ferizaj dhe Pejë. Çdo qendër ka karakter regjional. Informimi për hapjen e qendrave është bërë me kohë dhe nëpërmjet mediave si lokale ashtu edhe të nivelit të Kosovës.

Në bazë të këtij studimi, mund të arrijmë në përfundim që, mësimdhënësit me dëshirë vijën në qendër dhe e shprehin rëndësinë e qendrës në ngritjen e nivelit të mësimdhënjes. Mundësia për shfrytëzimin e qendrës dhe pajisjeve në qendër, si kompjuterëve, internetit dhe llojeve të ndryshme të trajnimeve, kontribon në zhvillimin e arsimit në Kosovë.

SHTOJCA I



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

KEC

SHTOJCA II




Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

KEC


SHTOJCA III

Fotografitë e qendrat didaktike në Ferizaj



SHTOJCA IV

Fotografitë e qendrat didaktike në Prizren



SHTOJCA V

Milikije Halipi
Arsimtare - Histori
Sh. f. "Gjoni Serreqi"

Kapja e Gendres Didaktike është një ndihmesë e madhe për të gjithë mësuesit dhe komunistë por edhe të atyre përveç. Në këtë gendër po bëhen trajnime të shumta si për metodat e reja të mësimit paqartë edhe kurse të tjera si të gjuhës angleze, kompjuterit etj.

Albajtja e këtyre trajnimeve është një sukses i madh dhe por con në ngritjen e metodologjive mësimore, mësuesit kanë mundësinë që të përdorin internetin dhe gjithëditë mjetet e konkretizimit që janë në gendër shfrytëzohen maksimalisht nga mësuesit.

Në fund theksojmë kapja e gendrave të tilla është e nevojshme dhe e domosdoshme edhe në komunat tjera.

Jabri Perizha
DREJTOR
SHF. "GJON SERRIÇI"
FERIZAJ

14.02.2002

Qendra didaktike është ndihmuese
e madhe për ushtrimin dhe trajnimin
e mësuesve me metoda bashkohore
qandaj mendoj se në çdo gjetje të
kësorës luptojmë të ketë krye qendra.

Ndihmues e procesit mësues është
e madhe me ushtrimet dhe trajnimet
që bëhen në Qendrën Didaktike.

14.02.2002

Lindita Ysufi

Drejtoreshë

Shkolla e muzikës „Gersh Gadeja“ Ferizaj

Thopja e Qendres Didaktike i dha ndihmë të madhe punitoreve që jemi të ligur në procesin edukativor arsimor.

Arsimtarët në këtë qendër mund të përfitojnë shumë njohuri nëpërmes kurseve dhe seminareve që po organizohen.

Këtu mësuesit po kanë mundësi të mësojnë metodat dhe të përdorin ujërat në bashkohore gjë që po u ndihmon shumë në zhvillimin normal të procesit mësuesor.

SHTOJCA VIII

Luzana Ajdini-Hauza
Arsimtare e matematikës
Sh.f. "GJON SERRIQI" - FERRIS

14.02.2002

Quesha didaktike është ndihmësi e madhe për mësimdhënësit, sepse na ofron mjete dhe materiale për zhvillimin e procesit mësimor. Na është mundësuar ndjekja e kursit të kompjuterëve si dhe të gjuhës angleze. Me materialet e gjuhës krijojmë modele, ilustrime që na lehtësojnë mësimin dhe onës mësimore. Në gjuhës rubatën edhe seminarë për trajnimin e arsimtarëve për aplikimin e metodave të reja mësimore. Këtu takohemi arsimtarë nga shkollat të ndryshme dhe bëjmë këmbim të mendimeve dhe bashkëpunim për zgjidhjen e nivelit në mësim.

AKTIVITETE NË QENDRËN DIDAKTIKE

Në hapjen solemne të Qendrës Didaktike kam qënë e ftuar si mysafire dhe kam pas nderin të jam anëtare e pare e kësaj Qendre.

Mëpastaj rregullisht kam bashkëpunar në këtë Qendër, si arsimtare e matematikës, ku bëja përgatitjet për orë, me ndihmën e stafit punues të kësaj Qendre.

Së shpejti mu dha rasti edhe të punësohem këtu si ndihmëskoordinatore.

Jam gjithmonë në gjendje gadishmërie për të ndihmuar kolegët e mi mësues. Këtu pos përgatitjeve për orë që bëjnë arsimtarët me material falas, organizohen edhe debate të ndryshme për ngritjen e nivelit të mësimin

Çdo ditë kemi anëtarë të rinj që na bënë me dije se ngritet interesimi për punë në Qendër. Interesimi është shumë i madh rreth përgatitjeve dhe formulimeve të testeve për vlerësimin e njohurive nga lëndë të ndryshme.

Momentalisht jemi duke përgatitur një trajnim për arsimtarët e matematikës. Këtu e bëjmë me ndihmën e kolegëve të cilët kanë kryer trajnimet dhe që profesionalisht janë të përgatitur mire.

Prandaj u jemi shumë mirënjohës KEC-it dhe të gjithë atyre që dhanë ndihmesë në këtë drejtim.

Ndihmëskoordinatore e Qendrës Didaktike

Mejreme Nevzati

Mejreme Nevzati,

QENDRA DIDAKTIKE-PRIZREN

Me 25/05/2001 në Prizren u organizua hapja solemne e Qendrës së parë didaktike në Kosovë,në lokalet e shkollës fillore "Abdyl Frashëri"-Prizren.Kjo Qendër ka për qëllim t'i ndihmojë arsimtarët e regjionit të Prizrenit duke përfshirë këtu edhe komunën e Sharrit,Therandës,Rahovecit dhe Malishevës,për ngritjen e cilësisë së punës edukativo-arsimore duke përdorë teknika të reja,të verifikuara në arsimin e shteteve perëndimore.

Gjatë periudhës maj'2001-janar'2002,në Qendrën Didaktike,u anëtarësuan mbi 320 arsimtarë të shkollave fillore dhe të mesme të komunës së Prizrenit ku një numër i tyre ishin edhe nga komunat Sharr,Rahovecë dhe Therandë,të cilët u angazhuan së bashku me stafin punues të Qendrës Didaktike,në ndryshimin e punës edukativo-arsimore nga tradicionalja në bashkëkohore.Ata filluan të hartojnë lloje të ndryshme testesh të llojeve të ndryshme për klasë të ndryshme,t'i fotokopjojnë ato dhe t'ua shpërndajnë nxënësve dhe ate në gjuhën shqipe,turke e boshnjake pasi një numër i anëtarëve të Qendrës janë arsimtarë turq dhe boshnjak.U ndërtuan modele shkronjash për nxënësit e klasës së parë të cilat iu dhuruan nxënësve dhe ilustrime të ndryshme për shkronja.Gjatë periudhës në fjalë u fotokopjuan mbi 110.000 kopje të testeve,planifikimeve të orës,planeve mujore të arsimtarëve,etj.Poashtu,gjatë kësaj kohe u organizua kursi për kompjuter ku pjesërishtë u aftësuan mbi 60 arsimtarë të shkollave fillore dhe të mesme të cilët janë në gjendje që planet e tyre vetë t'i përgatisin në kompjuter sikurse edhe testet dhe dokumentacion tjetër shkollor.Arsimtarëve u është ndihmuar edhe me huazimin e ilustrimeve të biologjisë,diaprojektorëve,grafoskopëve,kasetofonëve,etj. me të cilët disponon Qendra Didaktike.

Nga stafi punues i Qendrës Didaktike,arsimtarët u ndihmuar edhe në mënyra tjera dhe me këshillime në takimet që u organizuan me arsimtarë sipas aktiveve profesionale dhe u avansuan dhe organizuan seminare të ndryshme të organizuara sipas programeve të Qendrës për Arsim të Kosovës (KEC).

Në të ardhmen stafi punues i Qendrës Didaktike do të fokusohet në pajisjen e Qendrës Didaktike më pajisje të nevojshme për të cilat ka nevojë Qendra Didaktike,organizimin e kurseve për kompjuter dhe gjuhë angleze,organizimin e seminareve me qëllim të trajnimit të arsimtarëve,etj.

Në fund një apel për arsimtarët e regjionit të Prizrenit: eni, shfrytëzoni mundësitë që u ofron Qendra Didaktike në Prizren.

Koordinatori i Qendrës Didaktike


/ Bedri Rexhepi /

QENDRA DIDAKTIKE-DRITARE E DITURISË

Me hapjen e Qendrës Didaktike në Prizren u krijua një burim kryesor për ndihmë arsimtarëve gjatë punës së tyre. Që në fillim, bashkëpunimi në mesë Institutit Pedagogjik dhe Qendrës Didaktike ka qenë në nivel të duhur duke bërë konsultime të ndryshme rreth punës së kësaj Qendre dhe mundësinë e dhënjes së kontributit të institutit pedagogjik, kësaj Qendre.


Në këtë Qendër janë bërë trajnimet e ndryshme të arsimtarëve ku arsimtarëve iu janë afrua kushte solide për mbarëvajtjen e këtyre trajnimeve.

Arsimtarët e qytetit të Prizrenit dhe rrethinës krijojnë material didaktik për mësimdhënje dhe mësimnxënje e të cilët shpeshë kërkojnë udhëzime nga punorët-këshilltarët e Institutit Pedagogjik e stafi punues i Qendrës Didaktike u ndihmon me këshilla, udhëzime dhe material të nevojshëm për krijimin e atyre mjeteve didaktike.

Punëtorët e Institutit Pedagogjik, në Qendrën Didaktike kanë kryer trajnime të ndryshme në lëminë e arsimit së bashku me stafin punues të Qendrës Didaktike dhe janë duke përgatitur së bashku një projekt për zbatimin e teknikave të reja të mësimdhënjes në lëndët e shkencave natyrore, e që më vonë parashifet të bëhet edhe trajnimi i arsimtarëve tjerë në këtë lëmi.

Këshilltarët pedagogjik dhe shumë punëtorë tjerë të arsimit, kanë kryer kursin për kompjuter në Qendrën Didaktike dhe janë aftësuar të përgatisin me kompjuter materialin e nevojshëm për mësimdhënje gjatë punës së tyre më nxënës.

Prizren
22/02/2002

Këshilltar (Inspektori) i matematikës

/ Halit Buzhala /